



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisje lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008", të nenit 8, paragrafi 2 të Ligjit Nr-03/L-087 për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-31/2008", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, e në mbështetje të nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës, në mbledhjen e mbajtur më datën, 20.05.2020, miratoj këtë;

V E N D I M

Për miratimin e raportit për vitin 2019, të komisionit komunal të aksionarëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A.

Neni 1

Miratohet raporti për vitin 2019 i performancës së Komisionit komunal të aksionarëve për ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi në NPL "Stacioni i autobusëve" SH.A. me seli në Suharekë.

Neni 2

Raporti i cekur në neni 1, të këtij vendimi është shqyrtuar dhe miratuar në pajtim me dispozitat e nenit 8, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-31/2008", i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009.

Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij vendim është raporti 01-Nr-052-13885 i datës 03.03.2020, i përgatitur nga anëtarët e Komisionit Komunal i Aksionarëve.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008"), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-18196
Me datë 21.05.2020



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI